

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

1. **Drejtuar: Operatorit Ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k**
2. **Adresa:** Durrës, Shkozë, Rruga “Dituria”, Zona Kadastrale nr.8516, nr pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007
3. **Nipt:** K01730502W
4. **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐JO ☒
5. **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐JO ☒
6. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi
7. Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**
8. Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-88899-06-04-2026**
9. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikualifikim Urban i bllokut që kufizohet nga rrugët “3 Vëllezërit Kondi” –“Elbasanit” – “Haki Shehu”, dhe rruga “Kolë Kamsi”.**
10. Fondi limit: **99,817,365.65** (nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e pesë) pa TVSH.
11. Burimi i financimit: me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, sipas VKB Nr.35, datë 30.03.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.
12. Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muaj kalendarik.
13. Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 22.07.2026
14. Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini nr. 47, datë 27 Korrik 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “2 N” sh.p.k & “AVDULI” sh.p.k

NUIS L31615017L & NUIS J66703306O

Vlera: 56,635,041.00 (pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ALGES KONSTRUKSION” sh.p.k & “INERTI” sh.p.k

NUIS L92621601H & NUIS J66926804L

Vlera: 59,736,335.28 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k

NUIS 810802422

Vlera: 62,429,268.00 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Operatori Ekonomik “BE-IS” sh.p.k

NUIS K71412003A

Vlera: 67,714,876.00 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Operatori Ekonomik “CARA” sh.p.k

NUIS K07729920F

Vlera: 68,278,014.00 (gjashtëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a & “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k

NUIS J62904264O & NUIS K71401004W

Vlera: 69,572,704.92 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e katër pikë nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

7. Operatori Ekonomik “MARVELS”S Construction Group” sh.p.k NUIS J77506312B

Vlera: 72,846,310.00 (shtatëdhjetë e dy milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

8. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k NUIS K01730502W

Vlera: 75,042,032.10 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyzet e dy mijë e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

9. Operatori Ekonomik “K.M.K” sh.p.k NUIS L78223801E

Vlera: 76,037,352.00 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

10. Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” sh.p.k NUIS K81716011V

Vlera: 78,189,302.00 (shtatëdhjetë e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dy) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B93 II” Sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k
NUIS L52209050O & NUIS K53002402C

Vlera: 80,749,903.50 (tetëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

12. Operatori Ekonomik “CURRI” sh.p.k NUIS J67902718S

Vlera: 84,601,757.10 (tetëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dhjetë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

* * *

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “2 N” sh.p.k & “AVDULI” sh.p.k

NUIS L31615017L & NUIS J66703306O

- Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.3.13, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “2 N” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

- Nga ana e prodhuesit ABB për materialet elektrike mungon kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, certifikatën ose deklaratën e konfirmitetin CE dhe certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar.

- Per Prodhuesin General Gavi për materialet elektrike mungonjë certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar.

- Për Prodhuesin Olympia nuk ka paraqitur certifikatën ose deklaratën e konfirmitetin CE.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit (SPE), rezultoi se operatori ekonomik “2 N” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentat për materialet (elektrike, tuba, bojra) në gjuhen shqipe, bazuar në nenin 24 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët, pika 2 paragrafi i dyte parashikohet se: “...Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. ...” dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën autorizimet e kërkuara në shtojcën 8.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALGES KONSTRUKSION” sh.p.k & “INERTI” sh.p.k

NUIS L92621601H & NUIS J66926804L

- Operatori ekonomik “ALGES KONSTRUKSION” sh.p.k nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.2, ku percaktohet se: “Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të percaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);...”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALGES KONSTRUKSION” sh.p.k nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit në kontratën me objekt: “Plani i mobilitetit dhe Hartimi i hollësishëm i projektit të investimeve për azhornimin e integruar urban të Gjirokastrës- Paketa 2” dhe në kontratën me objekt: “Rikonstrukcion objekti civil 2 dhe 3 kate

mbi toke” nuk plotëson dokumentat e kërkuara si formularin e vleresimit për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, Aktin e kolaudimit dhe Çertifikatën e marrjes në dorezim. Nga verifikimi rezulton se operatori ekonomik “ALGES KONSTRUKSION” sh.p.k nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit në kontratën me objekt: Kompleks vila banimi 1,2,3 kat dhe me një kat nentok me mur rrethues Farke, Bashkia Tiranë" dhe " Nderhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranës (Nderim Godine)" të cilat nuk konsiderohen për nga natyra punime të ngjashme.

- Operatori ekonomik “INERTI” sh.p.k nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar mjetet sipas pikës 2.3.16 “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera të lidhura me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, konkretisht në objektet: 1 “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rruget "3 Dëshmoret" - "Kadri Roshi" dhe "Panajot Pano". 2. “Rikonstruksion i rrugës "Pjeter Budi".

Referuar Pikës 2.3.16 të DST, gërma g, është kërkuar “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k

NUIS 810802422

- Operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma f, ku përcaktohet se: “Për mjetet që sipas përcaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojiten targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k nuk ka deklaruar targat, nr e shasisë dhe nr e lejes së qarkullimit për mjetet Autobitumatrice dhe Eskavator me gomë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në rubrikat përkatëse dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës.

Gjithashtu operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k, nuk ka plotësuar rubrikat në formularin e vetëdeklarimit konkretisht për: Pjesa II: shkaqet e përjashtimit A: deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, rubrikat 9- operatori ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri.....

10- Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

11- Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë dhe 13- Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. (Referuar edhe vendimeve të KPP-së Nr.658/2025, Nr.656/2025, Nr.1779/2025, etj, mbi detyrimin e operatorëve ekonomikë ofertues për të plotësuar të gjitha rubrikat e parashikuara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit).

4. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k

NUIS K71412003A

- Operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma g , ku përcaktohet se: “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k i ka të anagzhuara mjetet në kontratat e prokurimit me objekt “Ndertim i rruges Zall Bastar/Vilëz” dhe “Ndertimi i rruges që lidh rrugën Myslym Qefalia Shish Tufine (Rr. Hasan Lici, Sefer Lika)” konkretisht: Grejder, autobitumatrice, autobot uji etj. Dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën sipas pikës 2.3.16 mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës.

5. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “CARA” sh.p.k

NUIS K07729920F

- Operatori ekonomik “CARA” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të DST pika 2.3.10 gërma b, ku përcaktohet se: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe subjektet mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës, duhet të deklarojnë për stafin e tyre të dhenat si më poshtë:

-Për punonjeshin teknik ndertimi, teknik topograf dhe teknik elektrik duhet të deklarohej emër/mbiemër, profili i punës, numer kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.

-Për punonjeshin e tjere te stafit teknik duhet të deklarohej emër/mbiemër, profili i punës, numer kontrate individuale të punës, numer dhe titull i kualifikimit për dëshmi /certifikatë/diplomë përkatëse, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar në Ligjin 15/2017.

Operatori ekonomik “CARA” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet

e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik rezulton se nuk ka paraqitur autorizimet e kërkuara.

Operatori ekonomik “CARA” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik 2.3 nënpika 2.3.16 “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk disponon asnje mjet autobitumatrice, për mjetin fadromë nuk janë deklaruar targa,per pasijet gazogjen, makineri per vijejime,vibrator,minieskavator,saldatrice nuk ka shenuar asnje te dhene, i mungon nje kamion me kapacitetit 10-20 ton dhe kamioncine me kapacitet 3-5 ton.

Gjithashtu Operatori ekonomik “CARA” sh.p.k nuk plotëson skërkesat sipas DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3 nënpika 2.3.15 ku përcaktohet se : “Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Pasi nga verifikimi i dokumentacioni të deklaruar në SPE operatori ekonomik “CARA” sh.p.k nuk ka paraqitur Licencen e sipërcituar.

6. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” sh.a & “Kevin Construksion” sh.p.k

NUIS J62904264O & NUIS K71401004W

- Operatori ekonomik “Kevin Construksion” sh.p.k nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.11 gërma a, ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbeshtetes te deklaruar nga operatorët pjesemarres si subjekt mbeshtetes duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik , rezultoi se operatori ekonomik “Kevin Construksion” sh.p.k ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale për Bulozeristin me inicale E.Gj me afat vlefshmërie 19.04.2026, e cila rezulton me afat të skaduar dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për punonjësit e kërkuar në shtojcën 8.

7. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MARVELS”S Construction Group” sh.p.k
NUIS J77506312B

Pas kontrollit rezultoi se oferta e operatorit ekonomik “MARVELS”S Construction Group” sh.p.k është me cmim anomalisht të ulët. Referuar nenit 82 pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), parashikohet se: “...Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve....”.

8. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k
NUIS L78223801E

- Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k ka deklaruar drejtuesin teknik me inicialet Sh.H i cili rezulton i angazhuar me kohe të plote në kontratën me objekt: “Rehabilitimi I bllokut që kufizohet nga rrugët “Mihal Gramen”-“Todi Shkurti”-dhe “Zonja Curre” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

9. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” sh.p.k
NUIS K81716011V

- Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” sh.p.k nuk plotëson kërkesat sipas DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3 nënpika 2.3.15 ku përcaktohet se : “Operatori Ekonomik duhet të disponojë License të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Pasi nga verifikimi i dokumentacioni të deklaruar në SPE operatori ekonomik Company Riviera 2008 sh.p.k ka paraqitur Licencën e sipërcituar, por rezulton se kjo licence është për transport të mbetjeve inerte dhe dherave dhe jo “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”.

10. Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k
NUIS L52209050O & NUIS K53002402C

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k nuk plotëson kërkesat sipas DST, Kapaciteti Teknik pika 2.3 nënpika 2.3.15 ku përcaktohet se: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Pasi nga verifikimi i dokumentacioni të deklaruar në SPE operatori ekonomik “B93 II” shpk ka paraqitur Licencën 3 IIB, por rezulton se kjo licence është për transport të mbetjeve jo të rrezikshme inerte ndërsa operatori ekonomik “ASI-2A CO” sh.p.k ka paraqitur licence për transport të mbetjeve inerte, por asnjëri nga operatorët nuk ka paraqitur licence “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k nuk përmbushin Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik 2.3 nënpika 2.3.16 “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...” pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk disponojnë kërkesën për 2 (dy) Autobitumatrice, pasi nga verifikimi rezulton se mjeti autobitumatrice deklaruar nga operatori ekonomik “B93 II” sh.p.k nuk ka shënuar nr e lejes së qarkullimit dhe nr e shasisë.

11. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k

NUIS J67902718S

- Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit ku përcaktohet se: “Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit që është mbështetur në subjekte të tjera dhe nuk ka paraqitur formularët përmbledhës të vetëdeklarimit për çdo mbështetës.

- Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.10 gërma b, ku përcaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe subjektet mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës, duhet të deklarojnë për stafin e tyre të dhenat si më poshtë: Për punonjës të teknik ndërtimi, teknik topograf dhe teknik elektrik duhet të deklarohet emër/mbiemër, profili i punës, numër kontrate individuale të punës, diploma përkatëse e shkolles së mesme si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit, diploma përkatëse e shkolles së mesme si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për punonjës të teknik topograf të kërkuar në shtojcën 8.

- Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 gërma c, ku përcaktohet se: “Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar

SSH/DIN/EN/UNI 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/UNI 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar SSH/DIN/EN/UNI 45001-2023 ose ekuivalente....”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur ne sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k ka deklaruar çertifikatën ISO 45001:2018 me afat vlefshmërie të skaduar dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI 45001-2018.

- Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16, ku percaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur ne sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit kamioncine me kapacitet 1.05 ton kur është kërkuar Kamioncine me kapacitet 3-5 ton dhe për pasojë nuk përmbush kërkesën për mjetet që nevojiten në dispozicion për zbatimin e kontratës.

- Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.13, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur ne sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k nuk ka paraqitur asnje autorizim prodhuesi ose distributori, kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit për materialet (elektrike, tuba, bojra), katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar.

Mangësitë e sipërcituara u konfirmuan nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Mbështetur në Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....”*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k, Nipt: K01730502W** dhe me adresë: Durrës, Shkozë, Rruga “Dituria”, Zona Kadastrale nr.8516, nr pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **75,042,032.10** (shtatëdhjetë e pesë milion e dyzet e dy mijë e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JOX